

**Studimi bazë:**

Gjendja aktuale në Mal të Zi,  
Evropë dhe botë lidhur me të ashtuquajturën

# ***pornografinë hakmarrëse në legjisla- cionin penal***





---

**Autorja:** Aleksandra Glligoroviq, MA  
**Redaktorja:** Aida Peroviq  
**Lektorja:** Dr. Radmilla Llazarevii  
**Përkthimi në gjuhë shqipe:** Agron M. Camaj  
**Botuesi:** OJQ Prima, Podgoricë  
Dhjetor 2021



---

Ky publikim është punuar në kuadër të projektit “Të vetëdijshme. Të sigurtat. Të mbrojtura.” Ky projekt financohet nga Ambasada e SHBA në Podgoricë. Mendimet, konstatimet, përfundimet ose rekomandimet e paraqitura këtu janë qëndrime të autores dhe nuk pasqyrojnë doemos pikëpamjet e Departamentit të Shtetit/Qeverisë së SHBA.

---

# ***Përmbajtja***

---

04	Hyrja dhe konceptet kryesore
08	Mali I zi: mbrojtja e personave nën moshën 18 vjeçare në rast të publikimit të fotografive, materialeve audiovizive ose materialeve të tjera pornografike
11	Mali I zi: mbrojtja e të rriturve në rast të publikimit të fotografive, materialeve audiovizive ose materialeve të tjera pornografike
17	Pasojat
20	Analiza e kuadrit ligjor në be dhe vende të tjera
24	Vendet ku ekziston kriminalizimi I qartë
26	Belgjika
28	Franca
29	Italia
30	Holanda
31	Spanja
33	Irlanda
34	Malta
35	Portugalia
36	Suedia
38	Polonia
39	Vendet ku ekziston kriminalizimi jo-eksplicit dhe përdorimi I dispozitave të tjera të legjislacionit penal
41	Përfundime dhe rekomandime



# Hyrja dhe konceptet kryesore

Sjellja e analizuar në këtë dokument përbëhet nga përhapja, kryesisht përmes internetit, të video përmbajtjeve dhe imazheve intime, ose imazheve private dhe imazheve të natyrës seksuale të marra me ose pa pëlqimin e personit në imazh, video ose audio incizim.

Ky lloj krimi bie nën përkufizimin e përgjithshëm “të dhunës me bazë gjinore ndaj grave me ndihmën e TIK-ut, dmth. teknologjive të informacionit dhe komunikimit (ang. ICT – Information and Communications Technologies). Domethënë, teknologjitë e reja kanë krijuar mjete të reja të ndërveprimit shoqëror që sfidojnë format tradicionale të sjelljes sociale, duke sjellë rreziqe pozitive dhe negative.<sup>1</sup>

Ka forma të ndryshme të dhunës në internet, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ndjekjen në internet, postimin e përmbajtjes pornografike pa pëlqimin e viktimës, fyerjet dhe ngacmimet me bazë gjinore, poshtërimin seksual, detyrimin e viktimës për të parë materiale pornografike, zhvatjen seksuale, kërcënimet me përdhunim dhe vdekje, publikimin e të dhënave private të viktimës dhe trafikimin me qenie njerëzore të mundësuar nga përdorimi i teknologjisë.<sup>2</sup>

Autori i këtyre veprave penale mund të jetë një ish-partner që ka marrë fotografi ose video incizime gjatë një lidhjeje të mëparshme dhe synon të turpërojë dhe poshtërojë publikisht

viktimën në shenjë hakmarrjeje për përfundimin e lidhjes. Megjithatë, në shumë raste, fotografitë janë marrë përmes të ashtuquajturit hakerimit (ndërhyrja e paautorizuar) të kompjuterit të viktimës, profilit në rrjetet shoqërore apo telefonit, dhe qëllimi më së shpeshti është dëmtimi i jetës së atij personi.<sup>3</sup>

Ekspertët dhe ekspertet paralajmërojnë se është e gabuar të konceptohet dhuna ndaj grave dhe vajzave në internet si një fenomen krejtësisht i veçantë në raport me dhunën në “botën reale”, por se është më korrekte të konsiderohen si një tërësi.<sup>4</sup>

Herë flasim për publikimin e fotografive dhe videove të të miturve dhe fëmijëve, herë janë në pyetje të rriturit. Megjithatë, shpërndarja e fotografive dhe videove të fëmijëve edhe më parë është njohur si një krim që quhet “pornografia e fëmijëve”, por vetëm në kohët e fundit është njohur se ndarja e fotografive intime të të rriturve pa pëlqim, shpesh e quajtur në gjuhën e folur “pornografia hakmarrëse”, “pornografi prej hakmarrjes”, ose “pornografia pa pëlqim” gjithashtu kërkon kriminalizim.

---

1 Al Cooper, ‘Sexuality and the Internet: Surfing into the New Millennium’ (1998) 1 Cyber Psychology and Behavior 187; Pat O’Malley, Risk, Uncertainty and Government (Glass House Press 2004).

2 Sipas hulumtimit të EIGE, nuk ka përkufizime të dakorduara në nivel të BE-së. Një shpjegim i formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave në internet mund të gjendet këtu: <http://wmcpeechproject.com/online-abuse-101/>

3 EIGE (2017), Dhuna ndaj grave dhe vajzave në internet, [https://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/ti\\_pubpdf\\_mh0417543hrn\\_pdf\\_web\\_20171026164002.pdf](https://eige.europa.eu/sites/default/files/documents/ti_pubpdf_mh0417543hrn_pdf_web_20171026164002.pdf)

4 ibid.



Megjithatë, koncepti i “pornografisë hakmarrëse” është problematik, sepse “jo të gjithë autorët e kësaj vepre janë doemos të motivuar nga hakmarrja dhe jo çdo përmbajtje mund të kuptohet gjerësisht si pornografike”<sup>5</sup>. Kjo gjë mund të përfshijë gjithashtu “upskirting” (p.sh. fotografimin, zakonisht në vende publike, të pjesëve private të trupit ose të brendshmeve të personave që nuk dyshojnë fare asnjë gjë, të cilat më vonë shpërndahen në faqet publike të internetit), por edhe manipulimin e fotografisë së një personi nëpërmjet “Photoshop-it” kur një fotografi e kokës së dikujt vendoset në një fotografi seksuale të një trupi tjetër (i quajtur gjithashtu “deepfake seksual” dhe “media sintetike”)<sup>6</sup>. Pra, me përdorimin e teknologjisë është e mundur të krijohen fotografitë seksuale shumë realiste të një personi pa pëlqimin e tij dhe jo vetëm fotografitë por edhe video incizimet.

Ky është një koncept relativisht i ri, megjithëse në thelb nuk është edhe aq i ri, pasi ka qenë i pranishëm që nga fillimet e përdorimit të internetit, por në vitet e fundit ka marrë shumë më tepër hov me përdorimin e telefonave të mençur

---

5 Kirchengast, T. Crofts, T. (2019) ‘The Legal and Policy Contexts of “Revenge Porn” Criminalisation: The Need for Multiple Approaches’, [www.academia.edu/40071191/The\\_legal\\_and\\_policy\\_contexts\\_of\\_revenge\\_porn\\_criminalisation\\_the\\_need\\_for\\_multiple\\_approaches](http://www.academia.edu/40071191/The_legal_and_policy_contexts_of_revenge_porn_criminalisation_the_need_for_multiple_approaches)

6 Dunn, S. (2020), ‘Technology-Facilitated Gender-Based Violence. An Overview’, Centre for International Governance Innovation, [www.cigionline.org/sites/default/files/documents/SaferInternet\\_Paper%20no%201\\_0.pdf](http://www.cigionline.org/sites/default/files/documents/SaferInternet_Paper%20no%201_0.pdf)



dhe aplikacioneve që lejojnë fshehjen e adresës IP të dërguesit, gjë që autorëve të këtyre veprave ua mundëson shkallën e lartë të sigurisë dhe shmangien e përgjegjësisë për veprën e kryer.

Një rrethanë cilësuese plotësuese është mundësia e mbajtjes së një fotografie ose videoje në një hapësirë të caktuar virtuale vetëm për një kohë të caktuar, të kufizuar (disa sekonda ose minuta), pas së cilës kohë nuk mund të qaset më në atë adresë - por dëmi tashmë është bërë sepse materiali tashmë është shkarkuar nga përdoruesit e shumtë, që e kanë ruajtur në pajisjet e veta (kompjuterë, tabletë apo telefona të mençur) dhe mund të vazhdojnë shpërndarjen e tij nga adresa të tjera.

Për sa më sipër, është e vështirë për ekspertët/ ekspertet vendas, përfshirë edhe policinë, gjyqtarët dhe prokurorët, të mbledhin prova dhe të arrijnë deri tek një aktgjykim për dëmin e shkaktuar, si dhe të sigurojnë mbrojtje për viktimat e këtij lloji të dhunës, veçanërisht për të miturit, përfshirë fëmijët.

Kuadri ligjor bën një dallim të madh në lidhje me moshën e viktimës, kështu që vajzat dhe djemtë nën moshën katërbëdhjetë vjeç, në rast të publikimit të fotografive, materialeve audiovizive ose materialeve të tjera me përmbajtje pornografike të tyre, si dhe vajzat dhe djemtë të grupmoshës që nga katërbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç, mund të kërkojnë drejtësinë në përputhje me nenet 211 dhe 211a të Kodit penal të Malit të Zi.

Nga ana tjetër, vajzat dhe djemtë prej moshës tetëmbëdhjetë vjeç ose më të moshuar kanë më pak mundësi mbrojtjeje në raste të tilla.

# **Mali i Zi:**

## **mbrojtja e personave nën moshën 18 vjeç në rastin e publikimit të fotografive, materialeve audiovizive ose materialeve të tjera pornografike**

Mbrojtja e personave nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç nga kjo vepër penale është e përkufizuar qartë në Kodin penal të Malit të Zi. Në përputhje me këtë ligj, me termin “të miturit” përfshihen personat nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Përveç kësaj, si “fëmijë” konsiderohet personi nën moshën katërmëdhjetë vjeç, ndërsa si mitur konsiderohet ai person që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç dhe nuk i ka mbushur ende tetëmbëdhjetë vjet. Kjo është e rëndësishme për t’i kuptuar nenet e ligjit që i referohen kësaj fushe.

Me fjalë të tjera, në legjislacionin malazez në vitin 2017 është bërë ndryshimi i veprës penale të shfaqjes së materialit pornografik fëmijëve dhe prodhimi dhe posedimi i pornografisë së fëmijëve (neni 211), në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare, dhe e gjitha kjo me qëllim të mbrojtjes më të madhe të fëmijëve. Me ndryshimet e Kodit penal, në veprën penale të nenit 211, Pornografia e fëmijëve, është bërë harmonizimi me detyrimet që rrjedhin nga e Konventa e Lanzarotes dhe Konventa e Këshillit të Evropës për krimin kibernetik, në mënyrë që është futur përkufizimi i pornografisë së fëmijëve sipas të cilit nën pornografinë e fëmijëve konsiderohet “çdo material që në mënyrë vizuale e shfaq fëmijën që merret me sjellje seksual-

isht eksplicite ose të simuluar dhe çdo shfaqje e organeve seksuale të një fëmijës për qëllime kryesisht seksuale”. Në këtë mënyrë është futur përkufizimi i Pornografisë së fëmijëve në përputhje me nenin 20 paragrafin 2 të Konventës së Lanzarotes.

Ligji thotë se kushdo që një fëmijës ia shet, dhuron, shfaq ose përmes **paraqitjes** publike **me përdorim të teknologjive të informacionit dhe komunikacionit**, ose në mënyra të tjera vë në dispozicion fotografitë, tekstet, objekte audiovizive ose materiale të tjera me përmbajtje pornografike ose i shfaq atij një paraqitje pornografike, do të dënohet me burgim prej gjashtë muajve gjer pesë vjet.

Përveç kësaj, ligji parashikon dënimin me burgim prej një gjer tetë vjet për atë që nxit ose përdor një fëmijë për prodhimin e fotografive, objekteve audiovizive ose të tjera të përmbajtjes pornografike ose për paraqitje pornografike.

Ndëshkimet parashikohen edhe për personat që në mënyrë të paautorizuar xhirojnë, prodhojnë, ofrojnë, vënë në dispozicion, shpërndajnë, importojnë, eksportojnë, prokurojnë për veten ose për të tjerët, shesin, japin, shfaqin, ekspozojnë publikisht ose posedojnë fotografi, materiale audiovizive ose materiale të tjera pornografike (të pornografisë së fëmijëve).

Nëse vepra nga paragrafët 1 dhe 2 të nenit 211 të këtij ligji është kryer ndaj të miturit, autori do të dënohet me burgim që nga tre muaj gjer tre vjet.

Rrethanë cilësuese plotësuese është në raste kur vepra është kryer me dhunë ose kanosje

dhe atëherë është paraparë dënimi prej dy gjer dhjetë vjet.

Është paraparë që “objektet” e përmendura dmth. materialet e përmendura në këtë seksion të konfiskohen dhe të asgjësohen.

Krahas me sa më sipër, gjatë avancimit të kuadrit ligjor në Kodin penal është përfshirë edhe një vepër e re penale, e ashtuquajtura joshja e fëmijës me qëllim të kryerjes së veprave penale kundër lirisë seksuale (neni 211b). Aty thuhet se i rrituri që synon të kryejë veprën penale të dhunimit, akteve seksuale të paligjshme etj., duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit ose në ndonjë mënyrë tjetër organizon një takim me një fëmijë dhe ndërmerr masa që ky takim të realizohet, dënohet me burgim prej gjashtë muaj gjer pesë vjet. Shkaku për përfshirjen e kësaj vepre penale është detyrimi që rrjedh nga Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual (neni 23 i Konventës - Joshja e fëmijëve për qëllime seksuale). Për të gjitha veprat penale që e rregullojnë mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi seksual dhe shfrytëzimi seksual në përputhje me konventën, Kodi penal e parasheh dënimin me burgim.



# **Mali i Zi:**

## **Mbrojtja e të rriturve në rastin e publikimit të fotografive, materialeve audiovizive ose materialeve të tjera pornografike**

Kur flasim për të rriturit, pra personat e grupmoshës tetëmbëdhjetë vjeç e më shumë, në rastin e publikimit të fotografive, materialeve audiovizive apo materialeve të tjera pornografike, mundësitë e mbrojtjes ligjore janë shumë më të vogla.

Vetë Kodi penal e përmend veprën e **përgjimit dhe incizimit të paautorizuar** (neni 173 të Kodit penal) që njihet në rastin kur një person pa dijeninë e tij është përgjuar me mjete të posaçme ose është regjistruar biseda, deklarata ose kumtesa e saj që nuk ishin të qëlluara për kameramanin.

Përveç vetë “kameramanit”, ligji parashikon edhe përgjegjësinë e personit që i mundëson një personi të panjohur njohjen me një bisedë, deklaratë apo kumtesë të përgjuar pa autorizim, gjegjësisht incizuar me zë. Në të dyja rastet është paraparë gjobë ose burgimi deri në një vit, përveç nëse vepra është kryer nga punonjësi zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, të cilit më pas i parashihet një dënim shumë më i rëndë – burgim nga tre muaj gjer tre vjet.

Në rast fotografimit të paautorizuar, d.m.th. në rastin **kur një person në mënyrë të paautorizuar bënë një fotografi ose film, video ose incizim tjetër të një personi** dhe kështu ndërhy

ndjeshëm në jetën e tij personale ose një incizim të tillë ia dorëzon ose ia tregon incizimin e tillë një personi të tretë ose ndryshe e lejon atë të njihet me të, atë botë flasim për shkelje të nenit 174 të Kodit penal, gjë që kërcënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit (përveç rastit kur vepra është kryer nga një punonjës zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, që më pas i nënshtrohet një dënimi shumë më të rëndë - burgim nga tre muaj gjer tre vjet).

Nëse ndodh që dikush **publikon ose shfaq aktin, portretin, fotografinë, filmin ose fonogramin e natyrës personale pa pëlqimin** e personit që ka përpiluar aktin ose të cilit i referohet akti, ose pa pëlqimin e personit të paraqitur në portret, fotografi ose film ose zëri i të cilit është regjistruar në fonogram (ose pa pëlqimin e një personi tjetër, pëlqimi i të cilit kërkohet me ligj) dhe në këtë mënyrë ndërhyjnë ndjeshëm në jetën personale të atij personi, në përputhje me nenin 175 të Kodit penal parashikohet gjithashtu gjoba ose burgimi deri në një vit për autorin e veprës penale (përveç si në situatat e lartpërmendura, gjegjësisht nëse vepra është kryer nga punonjësi zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, kur parashikohet dënimi shumë më i rëndë - burgimi nga tre muaj gjer tre vjet).

Ligji e ka njohur situatën që ndodh shpesh, **kur një person i tretë mbledh dhe përdor të dhëna personale pa autorizim dhe merr në mënyrë të paautorizuar identitetin e një personi tjetër** (viktimës) që është jashtëzakonisht i pranishëm në online/hapësirën kibernetike kur e merr apo edhe e krijon profilin e rremë në media sociale (Facebook, Instagram, Tik Tok etj.) dhe duke përdorur identitetin e tij ndërhyjnë jetën personale të viktimës dhe cenon dinjitetin e tij personal dhe i sh-

kakton dëm. Dënimi i parashikuar për këtë vepër është me burgimi deri në një vit (neni 176 të Kodit penal), me përjashtim të rastit kur vepra kryhet nga një punonjës zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, kur dënimi është nga tre muaj gjer tre vjet).

**Për të gjitha veprat e sipërpërmendura nuk përmendet specifika që përfshijnë shpërndarjen e materialeve me përmbajtje eksplicite dhe pornografike dhe fitohet përshtypja se kjo situatë dhe pasojat e saj nuk janë marrë parasysh apo konsideruar në mënyrë specifike gjatë krijimit të këtyre zgjidhjeve ligjore. Prandaj, në rastin kur këto vepra penale përfshijnë shpërndarjen e materialeve eksplicite dhe pornografike, dënimet e parashikuara me këto nene të Kodit penal duken jashtëzakonisht të ulëta, duke pasur parasysh dëmin që këto vepra mund t'i shkaktojnë personit që ka qenë viktimë.**

Nëse materiali i incizuar përdoret për **shantazh**, viktimja mund t'i referohet nenit 251 të Kodit penal, që thotë se kushdo që “me qëllim të përfitimit të një pasurie të paligjshme për vete ose për të tjetrin, kërcënon një person tjetër që do të zbulojë diçka kundër tij ose një personi të afërt të tij, se do të dëmtonte nderin ose reputacionin e tyre, duke e detyruar atë të bëjë ose të mos bëjë diçka në dëm të pasurisë së tij ose të tjetrit, dënohet me burgim nga tre muaj gjer pesë vjet”. Nëse me këtë vepër është “përfituar shuma më e lartë se tremijë euro, autori do të dënohet me burgim nga një vit gjer tetë vite”; nëse përfitimi është më i madh se tridhjetë mijë euro, dënimi është burgimi nga dy gjer dhjetë vjet, dhe në situatën kur kjo vepër është “kryer nga disa persona në mënyrë të organizuar” do të dënohet me burgim nga dy gjer dymbëdhjetë vjet.

Përveç sa më sipër, është me rëndësi që të theksohet se Mali i Zi e ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje., të ashtuquajturën Konventën e Stambollit, dhe në këtë mënyrë është detyruar për zbatimin e saj. Përkatësisht, Dekreti për shpalljen e Ligjit për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (“Gazeta Zyrtare e Malit të Zi - Marrëveshjet Ndërkombëtare”, Nr. 004/13 e datës 20.3.2013) është miratuar nga Kuvendi i Malit të Zi të legjislaturës së XXV, në seancën e parë të rregullt (pranverë) për vitin 2013, më datë 1 mars 2013 dhe është nënshkruar nga presidenti i Malit të Zi, Filip Vujanović.

Kjo Konventë thotë se “dhuna ndaj grave” nënkupton shkeljen e të drejtave të njeriut dhe se është një formë e diskriminimit të grave dhe përbën të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë dëme ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënimin me akte të tilla, detyrim ose privim arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike apo private. Prandaj, në procesin e mbrojtjes, është me rëndësi të mbahej parasysh neni 33 i kësaj Konvente, që e detyron shtetin për të marrë masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që sjellja e qëllimshme që cenon rëndë integritetin mendor të një personi me dhunë ose kanosje de-

---

7 Konvencija Savjeta Evrope o sprječavanju i suzbijanju nasilja nad ženama i nasilja u porodici. tzv. Istanbulska konvencija, [https://www.ombudsman.co.me/docs/1604494446\\_zakon-o-potvrđivanju-konvencije-savjeta-evrope-o-sprjecavanju-i-suzbijanju-nasilja-nad-zenama-i-nasilja-u-porodici.pdf](https://www.ombudsman.co.me/docs/1604494446_zakon-o-potvrđivanju-konvencije-savjeta-evrope-o-sprjecavanju-i-suzbijanju-nasilja-nad-zenama-i-nasilja-u-porodici.pdf)



tyrimisht të inkriminohet. Gjithashtu, se konform nenit 34 do të ndërmerren masat e nevojshme legislative ose masat e tjera për të siguruar që të jetë e inkriminuar përsëritja e qëllimshme e kërcënimeve ndaj një personi tjetër (përndjekja), që shkaktojnë që ai person të ketë frikë për sigurinë e vetë.





# Pasojat

Pasojat që një akt i këtij lloji shkakton dhe mund të lërë te viktimat janë jashtëzakonisht negative. Situata është veçanërisht e rëndë nëse bëhet fjalë për të rinjtë, ende emocionalisht të papjekur dhe jashtëzakonisht të pambrojtur gjatë adoleshencës (që sipas hulumtimeve të reja zgjat edhe deri në moshën 24 vjeçare), ku situata të tilla mund të shkaktojnë ankth, depresion dhe efekte të tjera negative në gjendjen e shëndetit mendore si rezultat i viktimizimit të tyre (Bates, 2017)<sup>8</sup>, në rastin më të keq mund të çojnë edhe deri tek vetëvrasja. Pavarësisht nga mosha, studimi i Nismës për të Drejtat Civile Kibernetike<sup>9</sup> thotë se 51% të viktimave kanë pasur mendime për vetëvrasje pas publikimit të fotografive të tyre, materialeve audiovizive apo përmbajtjeve të tjera pornografike.

Një studim i publikuar nga Instituti Evropian për Barazinë Gjinore tregon gjithashtu disa shembuj: italiania Ticiana Kantona bëri vetëvrasje në vitin 2016 pasi u publikua pornografia hakmarrëse për të cilën u pushua nga puna<sup>10</sup>; 15-vjeçarja Amanda Todd nga Kanadaja, që bëri vetëvrasje në vitin 2012 pasi një mashkull postoi foto të saj në internet pa pëlqimin e saj<sup>11</sup>; 17-vjeçarja Julia

---

8 Nonconsensual Pornography Among U.S. Adults: A Sexual Scripts Framework on Victimization, Perpetration, and Health Correlates for Women and Men, Y. Ruvalcaba and Asia A. Eaton (2018), <https://cybercivilrights.org/wp-content/uploads/2021/10/2019-Psychology-of-Violence-Publication.pdf>

9 Cyber Civil Rights Initiative, <https://www.cybercivilrights.org/wp-content/uploads/2014/12/RPStatistics.pdf>

10 <http://www.bbc.com/news/world-europe-37377286>

Rebecca nga shteti federal brazilian Piaui, që gjithashtu mori jetën e vetë në vitin 2013 pasi pamjet seksuale të saj dhe partnerit të saj u publikuan pa pëlqimin e saj<sup>12</sup>. Nuk ka të dhëna zyrtare për Malin e Zi, por në komunitet dihet për situata të vështira.

Demonstrimi i lidhjes midis viktimizimit të sh-kaktuar nga përhapja e “pornografisë pa pëlqim” dhe shëndetit dhe mirëqenies mendore është një hap i parë i rëndësishëm drejt përcaktimit të këtij fenomeni si një formë e abuzimit seksual dhe kuptimit të pasojave të mundshme shëndetësore të kësaj dukurie.

Skenarët seksuale deri më tani kanë stigmatizuar më shpesh gratë, por jo burrat, që janë seksualisht aktivë (Green & Faulkner, 2005),



---

11 <http://www.bbc.co.uk/newsbeat/article/19960162/amanda-todd-memorial-for-teenage-cyberbullying-victim>

12 <https://www.bustle.com/articles/9485-revenge-porn-legislation-called-for-in-brazil-following-17-year-olds-suicide>

kështu që shëndeti mendor dhe fizik i viktimave ndryshon sipas gjinisë.

Gratë kanë më shumë gjasa të përjetojnë reagime negative sociale si rezultat të viktimizimit, dhe për këtë arsye reagimet negative sociale janë një nga parashikuesit më të fortë të shëndetit negativ midis viktimave të sulmit seksual (Black et al., 2011; Dworkin, Ullman, Stappenbeck, Brill & Kaysen, 2018), kështu që gratë viktimat raportojnë shëndet më të dobët se viktimat e gjinisë mashkullore.

Megjithatë, edhe pse më shpesh flitet për pasojat tek vajzat dhe gratë, viktimizimi i djemve po bëhet gjithë e më i dukshëm.



# **Analiza e kuadrit ligjor në BE dhe vendet e tjera**

Në vitet e fundit në Shtetet anëtare të BE-së dhe në SHBA ka pasur më shumë raste të viktimave të publikimit të përmbajtjeve pornografike pa pëlqim, kryesisht të grave, gjë që ka bërë që shumë të prej tyre të bëjnë vetëvrasje. Rezultatet e studimit tregojnë se deri në 90% të viktimave të pornografisë hakmarrëse janë gra<sup>13</sup> dhe se numri i rasteve të tilla gjithnjë po rritet, për shembull, në Britaninë e Madhe<sup>14</sup>, dhe po rritet numri i faqeve të internetit të dedikuara për ndarjen e materialeve të tilla, ku përdoruesit mund të postojnë të dhëna personale si adresën e viktimës, lidhjen me profilet e viktimës në rrjetet sociale, madje edhe informacione për vendin e punës etj. Sipas një studimi të kryer në SHBA, informacionet e publikuara me materialin përfshifshin: emrin e plotë në 59% të rasteve, e-mailin në 26%, informacionin për rrjetet sociale/screenshot të profileve në media sociale në 49% të rasteve, adresën fizike të shtëpisë në 16% të rasteve, numrin e telefonit në 20% dhe adresën e punës në 14% të rasteve<sup>15</sup>.

---

13 Prema istraživanju koje je sprovela neprofitna organizacija Cyber Civil Rights Initiative 2015, <https://www.cybercivilrights.org/wp-content/uploads/2014/12/RPStatistics.pdf>

14 Vidjeti: <https://www.theguardian.com/technology/2015/jul/15/revenge-porn-cases-increase-police-figures-reveal>

15 A Campaign of the Cyber Civil Rights Initiative, Inc. [www.EndRevenge-Porn.org](http://www.EndRevenge-Porn.org); [www.CyberCivilRights.org](http://www.CyberCivilRights.org); <https://www.cybercivilrights.org/wp-content/uploads/2014/12/RPStatistics.pdf>

Në analizën “Kriminalizimi i dhunës me bazë gjinore ndaj grave në vendet evropiane, përfshirë dhunën me përdorim të” TIK (2021)<sup>16</sup>, të publikuar nga Komisioni Evropian – Rrjeti Evropian i Ekspertëve Ligjorë për Barazinë Gjinore dhe Mos-diskriminimin, theksohet se kur mungon kriminalizimi i kësaj praktike, ajo ndikon drejtpërdrejt në qasjen në drejtësi për viktimat, pasi alternativa e tyre e vetme duket të jetë që të paraqesin ankesa një platformës së caktuar interneti që shpërndan imazhe dhe të kërkojë heqjen e tyre, dhe një vendim i tillë mbetet kryesisht prerogativë e asaj platforme. Ata gjithashtu theksojnë se, megjithëse disa platforma kanë vendosur procedura për paraqitjen e kërkesave të tilla, përveç heqjes së materialit, viktimat nuk kanë asnjë formë kompensimi. Për më tepër, mundësia e përcaktimit të autorit (për shembull, bllokimi i profilit të tij, etj.) varet gjithashtu nga vendimi i platformës, ndërsa kriminalizimi i sjelljes së tillë do të lejonte ndërhyrjen e shtetit për të garantuar aksesin e viktimave në drejtësi, duke ruajtur të drejtën e autorit të veprës për një proces të drejtë.

Nga analiza e pyetësorit të zbatuar nga Komisioni Evropian me qëllim të krijimit të studimit të lartpërmendur, u konstatua se **njëmbëdhjetë shtete e kanë kriminalizuar në mënyrë specifike një sjellje të tillë në legjislacionin e vetë penal.**

---

16 Criminalisation of gender-based violence against women in European States, including ICT-facilitated violence (2021), S. De Vido, L. Sosa, published by EUROPEAN COMMISSION, European network of legal experts in gender equality and non-discrimination

Ndryshimet e legjislacionit penal të këtyre vendeve janë bërë kohët e fundit - në pesë vitet e fundit, ku gjashtë vende e kanë ndryshuar legjislacionin penal në vitet 2019 dhe 2020 – dhe pasqyrojnë nevojën për t’iu përgjigjur përdorimit të gjerë të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në kryerjen e veprave penale. Një pasqyrë e situatës mund të shihet në tabelën në vazhdim:

**Tabela:**

Përhapja e fotografive private pa pëlqim - kriminalizimi

<b>vendi</b>	<b>kriminlizmi eksplicit</b>	<b>kriminlizmi jo eksplicit</b>
Austria		●
Belgjika	●	
Bullgaria		●
Kroacia		●
Qiproja		●
Republika çeke		●
Danimarka		●
Estonia		●
Finlanda	●	
Franca		●
Gjermania		●
Greqia		●
Hungaria		●
Islanda		●
Irlanda	●	
Italia	●	



<b>vendi</b>	<b>kriminalizimi eksplicit</b>	<b>kriminalizimi jo eksplicit</b>
Letonia		●
Lihtenshtajni		●
Lituania		●
Luksemburgu		●
Malta	●	
Holanda	●	
Norvegjia		●
Polonia	●	
Portugalia	●	
Rumania		●
Sllovakia		●
Sllovenia		●
Spanja	●	
Suedia	●	
UK	●	

Burimi: KE, Kriminalizimi i dhunës me bazë gjinore ndaj grave në shtetet evropiane, duke përfshirë dhunën me përdorim të TIK (2021)

# Vendet ku ekziston kriminalizimi i qartë

Në analizë thuhet se “**pornografia hakmarrëse**” nuk është përdorur si shprehje në asnjë nga 11 vendet që e kanë kriminalizuar këtë sjellje, por përparësi kanë pasur nocionet e tjera, siç janë “distribucioni/përhapja/publikimi/shpërndarja pa pëlqim”.

**Tabela:**

Përhapja pa pëlqim - sjelljet dhe llojet e fotografive\*

<i>država</i>	<i>Përhapja/ Shpërndarja</i>	<i>Publikimi</i>	<i>Zbulimi</i>
Belgjika	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●
Franca	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●
Irlanda	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●
Italia	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●
Malta	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●
Holanda	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●
Polonia	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●
Portugalia	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●
Suedia	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●
Spanja	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●
UK	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●	● ● ● ● ●

- Natyra seksuale/përmbajtje eksplicite seksuale
- Private
- Intime
- Të tjerat

\*Kjo tabelë tregon vendet që e kanë kriminalizuar në mënyrë eksplicite shpërndarjen e fotografive private pa pëlqim.

Burimi: KE, Kriminalizimi i dhunës me bazë gjinore ndaj grave në shtetet evropiane, duke përfshirë dhunën me përdorim të TIK (2021)

Në analizë thuhet se pëlqimi është analizuar në lidhje me dy aspekte specifike të sjelljes: pëlqimin (ose mungesën e pëlqimit) për incizimin ose marrjen e fotografive/xhirimeve ose marrjen e video incizimeve që do të shpërndahen; dhe mungesa e pëlqimit për shpërndarjen e tyre. Këto paraqesin dy momente të ndryshme kohore, pasi incizimi/marrja e fotografive/videove i paraprin shpërndarjes së tyre.<sup>17</sup>

---

17 Criminalisation of gender-based violence against women in European States, including ICT-facilitated violence (2021), S. De Vido, L.Sosa, published by EUROPEAN COMMISSION, European network of legal experts in gender equality and non-discrimination

# Belgijka

Neni 371/1 i Kodit penal të Belgjikës<sup>18</sup> përkufizon voajerizmin dhe thotë se “kushdo që ka vëzhguar ose ka shkakuar që të vëzhgohet, ose ka bërë ose është detyruar të bëjë një incizim vizual ose audio të një personi: (i) drejtpërdrejt ose me mjete teknike ose në mënyra të tjera; (ii) pa autorizimin ose dijeninë e atij personi; (iii) kur personit i është ofruar ose është përfshirë në aktivitet seksual eksplicit; dhe (iv) në rrethanat kur mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që një person të mos shkelë privatësinë e tij ose të saj - shfaq, vë në dispozicion ose shpërndan fotografi ose incizime vizuale ose audio të personit që i ofrohet ose është përfshirë në aktivitet eksplicit seksual, pa pëlqim ose dijeni të saj, edhe nëse ai person ka dhënë pëlqimin për prodhimin e tyre - dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer pesë vjet.”

Belgjika në të njëjtën dispozitë (neni 371/1 (2) të Kodit penal) i referohet faktit se shpërndarja e fotografisë pa pëlqim **paraqet vepër penale edhe nëse personi ka dhënë pëlqimin për të dhe thotë se** “kushdo që ka treguar, vënë në dispozicion ose shpërndarë fotografitë ose një incizim vizual ose audio të një personi që i ofrohet ose është përfshirë në aktivitet seksuale eksplicite, pa pëlqimin ose dijeninë e tij ose të saj, edhe nëse ai person ka dhënë pëlqimin për prodhimin e tyre, dënohet nga gjashtë muaj gjer pesë vjet burgim”.

---

18 Neni 371/1 i Kodit penal, Belgjika (voyeurism), <https://resourcehub.baker-mckenzie.com/en/resources/fighting-domestic-violence/europe/belgium/topics/1legal-provisions>

Dënimi i parashikuar për këtë vepër nëse viktimja ishte nën moshën 16 vjeç është nga 10 gjer 15 vjet burgim. Për viktimat nën moshën 18 vjeç, ekziston një supozim i padiskutueshëm i mungesës së pëlqimit.

Është interesante të dihet se në prill të vitit 2020, Belgjika ka miratuar një **ligj të veçantë për shpërndarjen e fotografive dhe incizimeve seksuale pa pëlqim**, që përfshin gjithashtu aktin e shfaqjes dhe vënies në dispozicion të fotografive seksuale. Ligji përfshin gjithashtu video të një personi të zhveshur ose një personi të përfshirë në aktivitet seksual, që publikohen ose shpërndahen pa pëlqimin e atij personi. Është me rëndësi që vepra ekziston edhe nëse viktimja ka pranuar të fotografohet apo filmohet, por jo që të shpërndahen fotografitë.

Ky ligj është i rëndësishëm sepse vepra e pornografisë hakmarrëse është emërtuar nga fakti se në shumicën e rasteve është kryer nga një ish-partner për t'u hakmarrë, duke përdorur fotografi që nuk janë kontestuar në momentin e incizimit.

Ligji parashikon një gjobë nga 200 deri në 15.000 euro, si dhe një dënim të mundshëm me burgim nga gjashtë muaj gjer pesë vjet.

Gjithashtu, ligji përmban një dispozitë që lejon që fotografitë në fjalë të hiqen nga interneti dhe nëse kjo nuk është e mundur – nëse pronari i faqes së internetit është jashtë juridiksionit të gjykatave belge, për shembull – të bëhen të paarritshme nga një ISP belg (ofruesi i shërbimeve të internetit) sipas urdhrin të gjykatës ose thjeshtë të një prokurorit.

# Franca

Neni 226-1 i Kodit penal (Rregullorja nr. 2000-916 e datës 19 shtator 2000, neni 3, Gazeta zyrtare e datës 22 shtator 2002, hyrë në fuqi më 1 janar 2002)<sup>19</sup> thotë se dënimi me një vit burgim dhe gjoba prej 45 mijë euro do të shqiptohet për çdo cenim të qëllimshëm të privatësisë së të tjerëve duke përdorur çdo mjet për: 1) incizimin ose transmetimin e fjalëve të thëna në rrethana konfidenciale ose private, pa pëlqimin e personit që i ka folur; 2) fotografim, incizim ose dërgim të fotografisë së një personi që ndodhet në pronë private, pa pëlqimin e personit në fjalë.

Sipas nenit 226-2 të Kodit penal, të njëjtat gjoba zbatohen për mbajtjen, publikimin ose mundësimin e publikimit/shpërndarjes në publik ose me një palë të tretë, ose përdorimin në çfarëdo mënyre të çdo shkrimi ose dokumenti të marrë nga ndonjë prej akteve të listuara në nenin 226-1. Kur një vepër e tillë kryhet nëpërmjet shtypit ose emetimit, për përcaktimin e personave përgjegjës zbatohen dispozita të veçanta ligjore që rregullojnë këto çështje.

Megjithatë, ligji francez thotë se kur veprat e përmendura në këtë nen kryhen me dijeninë e personave të interesuara pa kundërshtimin e tyre, edhe pse ata ishin në gjendje ta bënin këtë, pëlqimi i tyre supozohet.

---

19 France\_Criminal Code, [www.legislationline.org/download/id/3316/file/France\\_Criminal%20Code%20updated%20on%2012-10-2005.pdf](http://www.legislationline.org/download/id/3316/file/France_Criminal%20Code%20updated%20on%2012-10-2005.pdf)

# Italia

Italia bën dallimin midis situatave në të cilat fotografitë janë bërë ose vjedhur dhe ato në të cilat fotografitë janë “marrë ose fituar ndryshe” (neni 612 i Kodit penal), që mund të përfshijnë një situatë në të cilën një person jep pëlqimin për krijimin e tyre. Në rastin e fundit, publikimi ose shpërndarja pa pëlqim është vepër penale kur ka për qëllim dëmtimin e viktimës. Vlen të theksohet se në Itali më 9 gusht 2019 ka hyrë në fuqi një ligj i ri për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, në përputhje me Konventën e Stambollit (Ligji nr. 69 i datës 19 korrik 2019, ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal, të Kodit të procedurës penale dhe dispozita të tjera për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore)<sup>20</sup>.

Italia ka bërë dallimin midis krijimit ose vjedhjes së fotografive që më pas shpërndahen pa pëlqimin e personit në fotografi – ku nuk parashikohet qëllimi për të dëmtuar – dhe marrja ose përdorimi i fotografisë në një mënyrë tjetër ku kërkohet qëllimi për të dëmtuar.

---

20 Ligji nr. 69 i datës 19 korrik 2019, Ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal, Kodit të procedurës penale dhe dispozita të tjera për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, mund të gjenden në italisht në lidhëzen: [www.gazzettaufficiale.it/eli/id/2019/07/25/19G00076/sg](http://www.gazzettaufficiale.it/eli/id/2019/07/25/19G00076/sg)

# Holanda

Neni i ri 139h i Kodit penal holandez, i miratuar në vitin 2020, bën dallimin midis: fotografive seksuale që janë “krijuar me dashje dhe në mënyrë të paligjshme” (neni 139h (1) (a)) dhe të publikuara ndërsa një person e di ose duhet të dyshojë në mënyrë të arsyeshme se fotografitë janë fituar ose si rezultat i një vepre penale të dënueshme sipas paragrafit (1) (a) (neni 139h (2) (a)); dhe fotografi seksuale - pa iu referuar mënyrës se si janë marrë – që publikohen “duke ditur se një publikim i tillë mund të jetë i dëmshëm për atë person” (Neni 139h, (2) (b)). Prandaj, siç thuhet në artikullin e M. Berndsen, “varianti nga paragrafi 2b gjithashtu e ndalon publikimin e fotografive seksuale të krijuara vullnetarisht, por më pas kërkon që publikuesi të dijë se publikimi mund të jetë i dëmshëm për personin e paraqitur në to.”<sup>21</sup>

---

21 (Berndsen, M. (2020) ‘A verb op wraakporno’, Nederlands Tijdschrift voor Strafrecht 2020-2, fq. 70-76, DOI <https://doi.org/10.5553/NTS/266665532020035002003>)



# Spanja

Kodi penal i Spanjës përkufizon këtë akt në pjesën “Veprat penale kundër privatësisë, të drejtës së dinjitetit të personit dhe paprekshmërinë e shtëpisë”. Gjithë kapitulli i parë ka të bëjë me zbulimin dhe shpalljen e sekreteve.

Neni 197 thotë se kushdo që merr letrat, letërkëmbimin, e-mailët ose çdo dokument tjetër ose sende personale me qëllim të zbulimit të sekreteve ose cenimin e privatësisë së të tjetrit, pa pëlqimin e tij, ose përgjon telekomunikacionin e tij ose përdor pajisje teknike për dëgjim, transmetim, incizim ose riprodhim të zërit ose të fotografisë, ose të çdo sinjali tjetër komunikues, dënohet me burgim nga një gjer katër vjet dhe me gjobë. Të njëjtat dënime janë të parapara për këdo që merr, përdor ose modifikon, pa autorizim, në dëm të një pale të tretë, të dhënat e natyrës personale ose familjare të një personi tjetër që janë të regjistruara në skedarë kompjuterikë, elektronikë ose në media elektronikë të tjera, ose në ndonjë skedar tjetër ose regjistrim publik ose privat. Të njëjtat gjopa parashikohen për këdo që i qaset në çfarëdo mënyre pa autorizim, dhe që i ndryshon ose i përdor ato në dëm të subjektit ose të një pale të tretë. Gjithashtu, parashikohet një dënim me burg nga dy gjer pesë vjet nëse të dhënat ose faktet e zbuluara ose pamjet e regjistruara emetohen, shfaqen ose u vihen në dispozicion palëve të treta<sup>22</sup>.

Në nenin 197 (7) të Kodit penal Spanja ka përfshirë faktin që një fotografi ose incizim audioviziv

mund të ishte marrë me pëlqimin e personit. Gjykata Supreme e Spanjës ka vendosur që të dyja – fotografitë e marra nga autori me pëlqimin e viktimës dhe ato të dërguara vullnetarisht nga viktima – përfshihen nën termin “përvetësim”.



# **Irlanda**

Irska ima posebnu odredbu (odjeljak 3 – Uznemiravanje, Zakon o štetnoj komunikaciji i srodnim prekršajima iz 2020) koja predviđa prekršaj „snimanja, distribucije ili objavljivanja” kada „on ili ona snimi, distribuira ili objavi intimnu sliku druge osobe bez pristanka te druge osobe”. U tom smislu, distribucija bez pristanka slika koje su snimljene uz pristanak žrtve može potpasti pod Odjeljak 2 istog zakona, koji se odnosi samo na distribuciju, objavljivanje ili prijetnju distribucijom ili objavljivanjem intimne slike.

Naime, ovaj zakon ima za cilj da izmijeni pravni okvir koji se odnosi na uznemiravanje; da predvidi krivična djela koja se odnose na snimanje, distribuciju ili objavljivanje intimnih slika i da obezbijedi anonimnost žrtava tih djela; da se predvidi krivično djelo koje uključuje distribuciju, objavljivanje ili slanje prijeteće ili grubo uvredljive komunikacije, i u te i druge svrhe da se izmijene i dopune Zakon o krivičnim djelima protiv osoba bez smrtnog ishoda iz 1997, Zakon o kauciji iz 1997. i Zakon o nasilju u porodici iz 2018, i da obuhvati srodna pitanja<sup>23</sup>.

---

23 Harassment, Harmful Communications and Related Offences Act 2020, <https://www.irishstatutebook.ie/eli/2020/act/32/enacted/en/print#sec3>

# Malta

Në Maltë, neni 208e i Kodit penal parashikon se “kushdo që, me qëllim të shkakimit të shqetësimit, dëmtimit emocional ose dëmtimit të çfarëdo lloji, publikon një fotografi ose film seksual privat pa pëlqimin e personit ose personave të paraqitura në këtë fotografi ose film do të dënohet me burgim deri në dy vjet ose me gjobë prej së paku tre mijë euro (3.000 €) dhe jo më shumë se pesë mijë euro (5.000 €), ose do të dënohet me burgim dhe me gjobë.

Paraqiten disa raste kur një person nuk mund të jetë fajtor për një shkelje sipas këtij neni nëse: (a) ai ose ajo ka publikuar një fotografi ose film seksual ekskluzivisht për personin ose personat e përshkruara në këtë fotografi ose film; ose nëse (b) publikimi ishte i nevojshëm për qëllimin e parandalimit, zbulimit ose hetimit të një krimi; ose nëse (c) në masën e arsyeshme të nevojshme, publikimi lejohet nga gjykata ose prokuroria gjatë një procedure gjyqësore me kusht që gjykata ose prokuroria ta miratojë një gjë të tillë, fotografia ose filmi seksual do të vuloset, pa vonesë, nga procesmbajtësi ose zëvendësi i tij në atë gjykatë ose prokurori dhe do të jetë i disponueshëm vetëm për palët në proces gjyqësor ose përfaqësuesit e tyre ligjorë të autorizuar.”

Gjithashtu, ligji thotë se kur vepra e përmendur në këtë nen kryhet si mjet ose si pjesë e shantazhit, dënimi rritet me një shkallë.

# Portugalia

Në Portugali, vepra penale e “ndërhyrjes digjitale në jetën private” (neni 193 i Kodit penal) përfshin sjelljen e paligjshme të një personi që “krijon, ruan ose përdor një skedar të dhënash digjitale të një personi të identifikueshëm në lidhje me jetën e tij private” (Neni 193 (1)). Ligji Nr. 44/2018 ka ndryshuar dispozitat e Kodit penal për cenimin e privatësisë duke shtuar veprën penale të shpërndarjes “nëpërmjet internetit ose mjeteve të tjera të shpërndarjes në publik të gjerë, të dhënave personale, apo fotografive apo zërave që kanë të bëjnë me privatësinë e viktimës pa pëlqimin e saj”.<sup>25</sup>

Ky vend ka miratuar edhe ligjin nr. 44/2018, që ka përforcuar mbrojtjen personale të jetës private në internet, duke futur veprat e “përhapjes nëpërmjet internetit” ose nëpërmjet “përhapjes së përgjithshme publike” të “të dhënave personale që lidhen me privatësinë e një personi” (në lidhje me dhunën në familje) dhe “përhapja e të dhënave personale nëpërmjet internetit ose mjeteve të tjera të shpërndarjes së publikut të gjerë” (në lidhje me veprat penale nga nenet 190 deri në 195 të Kodit penal).

# Suedia

Në Suedi, kjo temë trajtohet në Kapitullin 4 - Shkeljet kundër lirisë dhe paqes.<sup>26</sup>

Seksioni 6a i këtij kreu thotë se personi që në mënyrë të paligjshme, me mjete teknike, ka fotografuar fshehurazi një person në një hapësirë të mbyllur në një apartament, ose në një tualet, gardërobë ose hapësirë tjetër të ngjashme, është fajtor për fotografim imponues dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Më pas, neni 6b thotë se personi i cili, duke përdorur në mënyrë të paligjshme informacionin e identitetit të një personi tjetër dhe në këtë mënyrë shkakton humbje ose shqetësim, është fajtor për keqpërdorim të identitetit dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

eksioni 6c jep detaje në lidhje me shpërndarjen e materialeve dhe thotë se një person që ndërhyr në jetën private të një personi tjetër duke shpërndarë:

1. fotografi ose informacione të tjera në lidhje me jetën seksuale të personit;
2. fotografi ose të dhëna të tjera për gjendjen shëndetësore të personit;
3. fotografi ose informacione të tjera për një person që i është nënshtruar një veprë penale që përfshin një sulm ndaj personit,

---

26 The Swedish Criminal Code, [www.government.se/49f391/contentassets/7a2dcae0787e465e9a2431554b5eab03/the-swedish-criminal-code.pdf](http://www.government.se/49f391/contentassets/7a2dcae0787e465e9a2431554b5eab03/the-swedish-criminal-code.pdf)

lirisë ose paqes së tij;

4. fotografitë e një personi në një situatë shumë të cenueshme; ose
5. fotografitë e trupit të një personi tërësisht ose pjesërisht të zhveshur, nëse shpërndarja mund t'i shkaktojë dëm serioz personit të cilit i referohet fotografia ose informacioni, është fajtor për cenim të paligjshëm të privatësisë dhe do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Seksioni 6c i Kodit penal përfshin shpërndarjen e fotografive pa pëlqimin edhe nëse ato janë marrë me pëlqimin e viktimës.

Odjeljak 6c Krivičnog zakonika pokriva širenje slika bez pristanka čak i ako su dobijene uz pristanak žrtve.



# Poljska

Në Poloni, vepra penale (neni 191a i ndryshuar në 2020) përfshin marrjen dhe shpërndarjen e fotografive të personave të zhveshura ose personave gjatë aktivitetit seksual. Dispozita është unike në mënyrë që kërkon që autori të bëjë një fotografi “me dhunë, kërcënim të paligjshëm ose mashtrim”, dhe për këtë arsye shpërndarja e fotografive të bëra me pëlqimin e personit të paraqitur nuk bie nën këtë dispozitë. Një rast i tillë mund të mbulohet nga dispozita të tjera të ligjit të përgjithshëm penal, si shpifja, fyerja dhe ndjekja.

Polonia përdor gjithashtu fjalën “emetim/përhapje”, të cilën gjykatat e kanë interpretuar për ta bërë fotografinë në përgjithësi të disponueshme, duke e bërë atë të qasshme për një rreth të papërcaktuar njerëzish, duke çuar në një situatë ku fotografia mund të konsiderohet përgjithësisht e disponueshme.<sup>27</sup>

---

27 Konarska-Wrzosek, V. (2018) ‘Commentary to Article 191a of the Penal Code’, WKP.





## **Vendet ku ekziston kriminalizimi jo-eksplicit dhe përdorimi i dispozitave të tjera të legjislacionit penal**

Disa vende nuk kanë një vepër penale specifike të shpërndarjes së fotografive seksuale/intime/private pa pëlqim, por kanë dispozita të tjera penale të zbatueshme për ndjekjen penale të veprave penale që i takojnë kësaj kategorie. Në një raport të Komisionit Evropian thuhet se dispozitat penale që zakonisht zbatohen më shpesh i referohen ndërhyrjeve në jetën private të një individi, megjithëse shpesh mungon referenca për natyrën seksuale ose intime të fotografive.

Në vendet ku ky akt nuk sanksionohet në mënyrë eksplicite nën këtë emër, por brenda ligjeve dhe neneve të tjera ligjore, kjo vepër nuk trajton në fakt çështje të tilla si pornografia hakmarrëse ose forma të tjera tipike të dhunës në internet me bazë gjinore, por shumë shpesh lidhet me përdorimin e paligjshëm të të dhënave personale, siç është rasti në Kroaci.

Në Kroaci, për shembull, shpërndarja e raportit mbi pushimin mjekësor të një personi në kundërshtim me rregullat e mbrojtjes së të dhënave dhe shpërndarja e fotografive seksuale pa pëlqim janë të përfshira në të njëjtën kategori, megjithëse në rastin e fundit ka një dimension të qartë specifik të dhunës me bazë gjinore.

Një pasqyrë e përgjithshme është dhënë në tabelë në vazhdim.

### Tabela:

Përhapja e fotografive private pa pëlqim - kriminalizimi jo eksplicit

<b>država</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>
Austria			●		
Bullgaria				●	
Kroacia	●				
Qiproja					●
Çekia	●				●
Danimarka	●				
Estonia	●				
Gjermania	●	●			
Greqia	●				●
Hungaria	●				
Islanda					●
Letonia	●				
Lihtenshtajni			●		
Lituania	●				
Luksemburgu	●				
Norvegjia	●				
Rumania	●				
Slllovenia	●				

- 1** Ndërhyrja në jetën private/ cenimi i privatësisë/ përdorimi i të dhënave personale dhe/ose identitetit
- 2** „Upskirting“
- 3** Ngacmimi seksual nëpërmjet komunikimit elektronik
- 4** Fyerja dhe shpifja
- 5** Të tjera

Burimi: KE, Kriminalizimi i dhunës me bazë gjinore ndaj grave në shtetet evropiane, duke përfshirë dhunën me përdorim të TIK (2021)

Gjermania mund të konsiderohet si një rast i veçantë, që përveç dispozitës për cenimin e privatësisë intime të një personi në fotografi apo pamje të tjera pa pëlqimin e tij (neni 201a (1) i Kodit penal), ka një dispozitë të veçantë për “upskirting” (neni 184k i ndryshuar më 9 tetor të vitit 2020), dhe thekson se një dënim deri në dy vjet burgim ose gjoba do të shqiptohet për këdo që “me dashje ose me vetëdije bën ose transmeton një fotografi të paautorizuar të organeve gjentiale, vitheve, gjinjve ose të brendshmeve që mbulojnë këto pjesë të trupit të një personi tjetër, nëse këto zona janë të mbrojtura nga pamja; 2. Përdor ose vë në dispozicion personit të tretë një fotografi të marrë si rezultat i kësaj vepre penale, ose 3. Me vetëdije vë në dispozicion një palës së tretë pa autorizim një incizim të autorizuar të një fotografie të llojit të përshkruar nën numrin 1.



# ***Përfundime dhe rekomandime***

Duke pasur parasysh analizën e kuadrit ligjor në Mal të Zi, si dhe analizën e kuadrit ligjor të vendeve të tjera, dhe në përputhje me situatën që lidhet me keqpërdorimin gjithë e më të madh të teknologjisë së informacionit me qëllim të shpërndarjes së video materialeve dhe fotografive përmes internetit me qëllim të përndjekjes, shantazhit dhe poshtërimit dhe shumë shpesh edhe hakmarrjes, lind nevoja e avancimit të zgjidhjeve ligjore në Mali i Zi.

- Të kriminalizohet shpërndarja pa pëlqim e fotografive dhe videove intime/seksuale, si dhe shpërndarja e fotografive rreme, do të thotë materiali i sajuar nëpërmjet përdorimit të mjeteve dhe programeve online (photoshop, etj.), duke theksuar ndikimin e përdorimit të TIK, që e ka përkeqësuar këtë dukuri. Ky rezultat mund të arrihet edhe me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit penal.
- Duke pasur parasysh cenueshmërinë e veçantë të adoleshentëve, por dhe të tjerëve, rekomandohet që edhe në rastet kur ekziston pëlqimi fillestar për incizimin/marrjen e fotografive ose videove, shpërndarja e tyre e mëtejshme pa pëlqim duhet të ndalohet dhe ky pëlqim fillestar nuk duhet të jetë relevant për përcaktimin e veprës penale.
- Të sigurohet që kriminalizimi të mos përjashtojë mjetet juridike në të drejtën civile, siç janë

kompensimi ose heqja e një fotografie të kon-  
testuar me vendim gjykatë.

- Në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian, për sa i përket juridiksionit, të sigurohet që vendi në të cilin fotografia është e disponueshme nëpërmjet internetit ose TIK duhet të ruajë kompetencën, edhe nëse vepra është kryer jashtë vendit.
- Të njihet nevoja për kërkime sasiore dhe cilësore, bazuar në këndvështrimin e viktimave, që do të siguronte informacionin relevant për gjendjen, veçanërisht për gatishmërinë e komunitetit dhe gatishmërinë e sistemit për t'u përgjigjur në raste të tilla.
- Të krijohen programe trajnimi për punonjësit e policisë, gjyqësorit dhe prokurorisë mbi dhunën në internet me perspektivë gjinore.
- Të krijohen dhe zhvillohen trajnime për fëmijët, të rinjtë dhe gratë mbi mundësitë e mbrojtjes në internet, format e abuzimit dhe dhunës në internet, si dhe për kuadrin ligjor për mbrojtjen.
- Të përmirësohet parandalimi duke përfshirë këtë temë në kurrikulat shkollore, veçanërisht për grupmoshat 11 deri në 18 vjeç.
- Të punohet për të ndryshuar perceptimet dhe qëndrimet tradicionale të rrënjosura tek publiku dhe për të zbatuar më shumë fushata afatgjata dhe të rregullta për të luftuar tabu-të ekzistuese në lidhje me seksualitetin, por edhe fushatat për të rritur ndërgjegjësimin për format e dhunës në përgjithësi, duke përfshirë dhunën në internet në Mal të Zi.



